



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.71/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e Shkallës së Dytë, në përbërje nga gjyqtari individual Faton Bajrami, në çështjen përmbarimore të kreditorit N.T.Sh. Rikon Sh.P.K., me seli në Prishtinë, rr. “Azem Jashanica”, nr.56, kundër debitorit Komuna e Gjakovës, me përfaqësues ligjor Vjollca Shyti, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkalles së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1156/22, të datës 12.10.2023, me datë 04.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit N.T.Sh. Rikon Sh.P.K., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkalles së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1156/22, i datës 12.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1156/22, i datës 12.10.2023, në dispozitiv e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Gjakovës, dhe e ka anuluar Urdhërin të Përmbaruesit Privat Flamur Bogaj P.nr.981/2021 të dt. 10.09.2021, dhe e ka përfunduar në tërësi përmbarimin në këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta aprovojë si të bazuar ankesën e kreditorit, dhe kjo çështje ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur debitori, duke propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e kreditorit dhe të vërtetohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkalles së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1156/22, i datës 12.10.2023.

Gjykata Komerciale, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori N.T.Sh. Rikon Sh.P.K., ka paraqitur propozim për përmbarrim, kundër debitorit Komuna e Gjakovës, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturat nr. SH-1142/2020, të datës 18.04.2020, në vlerë prej 307.66€, Fatura nr. SH-1135/2020, të datës 18.04.2020, në vlerë prej 135.00€, Fatura nr. SH-1130/2020, të datës 18.04.2020, në vlerë prej 336.00€, Fatura nr. SH-1112/2020, të datës 18.04.2020, në vlerë prej 217.50€, Fatura nr. SH-1085/2020, të datës 18.04.2020, në vlerë prej 63.00€, Fatura nr. SH-1131/2020, të datës 18.04.2020, në vlerë prej 168.00€, Fatura nr. SH-1123/2020, të datës 18.04.2020, në vlerë prej 54.00€, Fatura nr. SH-1124/2020, të datës 18.04.2020, në vlerë prej 111.00€, Fatura nr. SH-825/2019, të datës 29.03.2019, në vlerë prej 403.43€, Fatura nr. SH-1090/2020, të datës 18.04.2020, në vlerë prej 94.87€, Fatura nr. SH-1148/2020, të datës 18.04.2020, në vlerë prej 351.54€, Fatura nr. SH-2897/2019, të datës 31.10.2019, në vlerë prej 224.85€, Fatura nr. SH-2878/2029, të datës 31.10.2019, në vlerë prej 96.21€, Fatura nr. SH-857/2019, të datës 29.03.2019, në vlerë prej 109.79€, në emër borxhit për shumën e mjetëve, në lartësi prej 2,645.84 euro, mirëpo pas një pagese kreditori ka bërë precizimin e shumë nga vlera 2,645.84 euro në vlerën e saktë prej 2,477.84 euro, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe te gjitha shpenzimet e procedurës përmbarrimore.

Përmbarruesi Privat Flamur Bogaj, duke vepruar në bazë të propozimit për përmbarrim të kreditorit me urdhrin P.nr.981/2021 të dt. 10.09.2021, ka lejuar përmbarrimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori ka ushtruar prapësim duke theksuar se disa prej faturave janë tashmë të paguara dhe këto fatura janë në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, andaj i propozon gjykatës që të pezulloj çështjen përkoheisist.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori, duke theksuar se janë të pa bazuara pretendimet e debitorit në prapësim dhe se e kundërshton kërkesën e debitorit që të mos realizohet përmbarrimi duke theksuar se debitori nuk e ka dhënë asnjë arsye si ne kuptim te nenit 71 te LPP qe te aprovohet prapësimi, andaj edhe ka kërkuar që të refuzoi prapësimin, dhe urdhri përmbarrimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1156/22, i datës 12.10.2023, në dispozitiv e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Gjakovës, dhe e ka anuluar Urdhërin të Përmbarruesit Privat Flamur Bogaj P.nr.981/2021 të dt. 10.09.2021, dhe e ka përfunduar në tërësi përmbarrimin në këtë çështje përmbarrimore.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se me shikim në shkresat e lëndës ka gjetur se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarrim në bazë të dokumentit jo të besueshëm sic janë - Faturat nr. SH-1142/2020, të datës 18.04.2020, në vlerë prej 307.66€, Fatura nr. SH-1135/2020, të datës 18.04.2020, në vlerë prej 135.00€, Fatura nr. SH-1130/2020, të datës 18.04.2020, në vlerë prej 336.00€, Fatura nr. SH-1112/2020, të datës 18.04.2020, në vlerë prej 217.50€, Fatura nr. SH-1085/2020, të datës 18.04.2020, në vlerë prej 63.00€, Fatura nr. SH-1131/2020, të datës 18.04.2020, në vlerë prej 168.00€, Fatura nr. SH-1123/2020, të datës 18.04.2020, në vlerë prej 54.00€, Fatura nr. SH-1124/2020, të datës 18.04.2020, në vlerë prej 111.00€, Fatura nr. SH-825/2019, të datës 29.03.2019, në vlerë prej 403.43€, Fatura nr. SH-1090/2020, të datës 18.04.2020, në vlerë prej 94.87€, Fatura nr. SH-1148/2020, të datës 18.04.2020, në vlerë prej 351.54€, Fatura nr. SH-2897/2019, të datës 31.10.2019, në vlerë prej 224.85€, Fatura nr. SH-2878/2029, të datës 31.10.2019, në vlerë prej 96.21€, Fatura nr. SH-857/2019, të datës 29.03.2019, në vlerë prej 109.79€, në emër borxhit

për shumën e mjeteve, në lartësi prej 2,477.84 euro, mbi bazë të së cilës përmbaruesi privat e ka lejuar përmbarimin, por ky dokument përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase nuk i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 par 1, 3 dhe 37 të LPP-së, për faktin se këto dokumente nuk e ka cilësinë e dokumentit përmbarimor, e po ashtu nga shqimin në këto dokumente rezulton se nuk përmbajnë të gjitha elementet e kërkuar nga këto nene, për të cilat janë përshkruar shërbimet, shumën e detyrimi dhe kohën e përmbushjes, mirëpo faturat janë lëshuar në mënyrë të një anëshme dhe nuk janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit. Andaj edhe mbi bazën e këtyre fakteve gjykata e shkallës së parë e ka pranuar prapësimin e debitorit dhe e ka anuluar urdhrin përmbarimor.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkalles se Dyte, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, që është në përputhje me dispozitën nga neni 37 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, ku përcakton se: “*Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”, pra dokumenti në fjalë fatura është dorëzuar në mënyrë të një anëshme. Gjithashtu në bazë të dispozitës nga neni 29 par. 1 dhe 3 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, përcaktohet paragrafi 1 se: “*Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm*”. Ndërsa sipas paragrafi 3 përcaktohet se: “*Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokumentin- faturat të cilat nuk paraqesin dokument të besueshëm, pasi që të njëjtat janë të një anëshme dhe nuk janë treguar debitori, përkatësisht i njëjti është person juridik publik dhe komunikimin apo dorëzimin e shkresave e zhvillon përmes zyrës së pranimit dhe dokumenteve protokollare, e që në rastin konkret këto fatura- dokumente përmbarimore nuk përmbajnë vulën e pranimit të debitorit dhe nuk ka shënim se të njëjtat të jenë pranuar nga debitori. E po ashtu edhe gjykata e shkallës së dyte, pajtohet në tërësi me qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parëse ky dokument nuk përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase nuk i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 par. 1 dhe 3 dhe 37 të LPP-së, për faktin se ky dokument nuk e ka cilësinë e dokumentit përmbarimor dhe nuk është pranuar nga ana e debitorit në mënyrë të rregullt duke mos e nënshkruar-pranuar si institucion.

Kjo gjykatë vlerëson se palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë në gjykatën kompetente, për të provuar pretendimet e tyre rreth mos përmbushjes së detyrimeve që dalin nga raporti detyrimor dhe se fatura në fjalë, në këtë fazë, duke pasur parasysh çështjet kontestuese të lartcekura, si të tilla, janë të përshtatshme për përmbarim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së parë. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Gjykata e shkallës së dytë i shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore të kreditori, por të njëjtat nuk ndikuan në një vendim ndryshe.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.71/2024, me datë 04.06.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami d.v